KRONIKË E ZEZË

Gjuajtje me armë e hedhje të granatës, ndërpritet koncerti i Mozzikut në Gjilan

Pamje nga momenti kur Policia u ngjit në skenë ku po performonte reperi Mozzik

28 korrik 2023, 10:20

Shpërndaje në

Koncerti i këngëtarit Mozzik pas mesnate në Gjilan nuk ka shkuar siç duhet. Është dashur ndërhyrja e Policisë për ta ndërprerë atmosferën që ishte në një nga diskotekat e qytetit ku po performonte reperi nga Ferizaj.

Sipas përgjigjjes së Policisë për KOHËN, koncerti i Mozzikut u ndërpre pasi jashtë diskotekës është gjuajtur me armë zjarri dhe është hedhur një granatë dore – e cila nuk ka shpërthyer.

"Në vendin e ngjarjes është gjetur një gëzhojë e armës si dhe një granatë dore, e cila ishte e pashpërthyer. I dyshuari është larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur", thuhet në përgjigjjen e Policisë.

Tutje, Policia ka thënë se të gjithë personat që ishin brenda diskotekës janë evakuuar në mënyrë të sigurt.

"Nga ana e zyrtarëve policorë është bërë sigurimi i vendit të ngjarjes, ndërsa mjeti i pashpërthyer është menaxhuar dhe asgjësuar pa asnjë pasojë nga njësiti për deminim", vijon përgjijga e Policisë.

Rasti është regjistruar si "shkaktim i rrezikut të përgjithshëm", ndërsa arsyeja pse ka ndodhur ende po hetohet.

VIDEO:

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#MOZZIK #GJILAN

Aktakuzë ndaj një serbi për krime lufte në Kosovë

Një 28-vjeçar gjendet i vdekur brenda veturës në Prishtinë

Porositi vrasës me pagesë për ta ekzekutuar bashkëshortin shqiptar, arrestohet gruaja në Itali

Arrestohet një i mitur për dhunimin e raportuar në Vushtrri

Vrau me pushkë qenin endacak, arrestohet deçanasi

Dy punëtorë lëndohen rëndë në vendin e punës në Prizren

Motrat e mitura e raportojnë nënën në Polici, thonë se po iu shkakton presion psikik

TaboolaFeed

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored Lexo më shumë

Ja disa këshilla në lidhje me dhimbjen e kockave

Blog | Sponsored Lexo më shumë

Motrat e mitura e raportojnë nënën në Polici, thonë se po iu shkakton presion psikik

Dy vajza e kanë raportuar në Polici nënën e tyre. Vajzat në Podujevë kanë thënë se nëna po iu bën presion psikik duke iu shkruar në rrjete sociale. Policia pasi e ka marrë në pyetje, e …

Kohanet



Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored Lexo më shumë

TË TJERA

Policia vihet në kërkim të një 54-vjeçari, i dyshuar për dhunë në familje

Aksident në rrugën Prishtinë-Podujevë, pesë të lënduar

Vdiq një 50-vjeçar në Mitrovicë, dyshohet se ra nga lartësia e urës

Një i vdekur nga aksidenti në Bishtazhin të Gjakovës

Partnerët: Shkabaj

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!